



**UNIVERSITETI I PRIZRENT**  
**Fakulteti Ekonomik**

<b>PLANPROGRAMI MËSIMOR – SYLLABUS</b>								
<i>Niveli i studimeve</i>	BACHELOR	<i>Programi</i>	AB	<i>Viti akademik</i>	2019/20			
<b>LËNDA</b>		<b>KONTABILITETI MENAXHERIAL - KM</b>						
<i>Viti</i>	III	<i>Statusi i lëndës</i>	Obligative	<i>Kodi</i>		<i>ECTS kredi</i>		6
<i>Semestri</i>	VI							
<i>Javët mësimore</i>	15		<i>Orët mësimore</i>		<b>Ligjërata</b>		<b>Ushtrime</b>	
					2		2	
<i>Metodologjia e mësimt</i>	Ligjërata, ushtrime, punime seminarike, konsultime, teste, raste studimi, detyra							
<i>Konsultime</i>	Një orë para dhe një orë pas ligjëratave							
<i>Mësimdhënësi</i>	<b>Bekim Berisha</b>			<i>E-mail:</i>	<a href="mailto:haberisha@hotmail.com">haberisha@hotmail.com</a>			
				<i>Tel.:</i>	<b>044 / 278 896</b>			
<i>Asistenti</i>				<i>E-mail:</i>				
				<i>Tel.:</i>				

<b>Qëllimi studimor dhe përmbajtja e lëndës</b>	<b>Përfitimet e studentit</b>
<p>Ky kurs do t'u japë studenteve të vitit të tretë drejtimi Amdinistrim Biznesi-Kontabilitet njohuri themelore mbi konceptet bazë mbi kontabilitetin e menaxhimit dhe strategjitë. Ai përcakton rolin e menaxherit në biznesin e ndërmarrjes, na njeh me rëndësinë e planifikimit dhe ndikimin e mjediseve makro dhe mikro ekonomike në vendosjen e objektivave të biznesit. Në këtë kurs do të trajtohen çështje të tilla si planifikimi, organizimi, motivimi, dhe udheheqja e kontabilitetit të menaxhimit, të cilat do të thellohen më tepër në vitet ne vazhdim mbështetur në standardet ndërkombëtare. Një rëndësi e veçantë i kushtohet rolit të manaxhimit në shoqëi dhe në biznese qofshin këto fitimprurëse ose jo. Të gjitha njohuritë e mësipërme bazohen në arritjet më të fundit bashkëkohore në fushën e shkencave menaxheriale dhe përvojat shumëvjeçare të studimit të kontabilitetit dhe këtyre aspekteve në realitetin Kosovarë.</p>	<p>Për më tepër studentët në fund të këtij kursi do të kenë zhvilluar aftësitë e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Kuptimi logjik i koncepteve bazë mbi Kontabilitetin e menaxhimit dhe rolin e tij në raport me organizatën dhe shoqërinë në tërësi,</li> <li>• Kuptimi i funksioneve menaxheriale dhe lidhjes ndërmjet tyre,</li> <li>• Aftësia për të asociuar konceptet teorike me situata të ndryshme në kontabilitetin menaxherial në praktikë,</li> <li>• Konsolidimi i njohurive bazë, me qëllim zhvillimin e tyre të mëtejshëm në lëndë të tjera menaxheriale.</li> <li>• Gjenerimin e një perspektive strategjike,</li> <li>• Manaxhimin e procesit të ndryshimit,</li> <li>• Krijimi dhe zhvillimi i grupeve në Kontabilitetin e menaxhimit</li> <li>• Gjetjen e burimeve të informacionit dhe vleresimin e situatave reale si dhe zhvillimin e mendimit kritik,</li> <li>• Përmiresimin e komunikimit dhe prezantimit verbal dhe të shkruar.</li> </ul>

<b>Metodologjia për realizimin e temave mësimore:</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Gjatë zhvillimit të seminareve theksi vendoset në përsëritjen, kuptimin logjik, konsolidimin e njohurive teorike të marra në leksione (në formën e testeve 20 minutëshe) dhe mbi të gjitha zhvillimin e aftësisë për zbatimin praktik të tyre.</li> <li>▪ Një pjesë të konsiderueshme të seminarit e zë puna me grupe të vogla studentësh (4 - 5 studentë), të cilëve iu jepen për diskutim raste të caktuara studimore nga realiteti kontabilitetit menaxherial, në botë dhe në Kosovë.</li> <li>▪ Në fund të orës së seminarit formulohen konkluzionet përmbledhëse, si dhe caktohen detyra për</li> </ul>

seminarin pasardhës.

<b>Kushtet për realizimin e temës mësimore:</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>Tabela, kompjuteri , projektori dhe mjete të tjera të nevojshme për mesim dhe ushtrime.</li> </ul>			
<b>Mënyra e vlerësimit të studentit ( në %) :</b>		<b>Vlerësimi në %</b>	<b>Nota përfundimtare</b>
Vijimi i rregullt	10.00 %	91-100	10 (dhjetë)
Kolokfiumi	20.00 %	81-90	9 (nëntë)
Seminaret dhe angazhime tjera	5.00%	71-80	8 (tetë)
Provimi final	65.00 %	61-70	7 (shtatë)
<b>Gjithsej</b>	<b>100.00 %</b>	51-60	6 (gjashtë)
		00-50	5 (pesë)

<b>Obligimet e studentit:</b>			
<b>Ligjërata</b>	<b>Ushtrime</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>Vijimi i ligjëratave</li> <li>Pjesëmarrja aktive në diskutime gjatë ligjëratave</li> <li>Punimi seminarik</li> <li>Pjesëmarrja në teste</li> <li>Provimi përfundimtar</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Pjesëmarrja në ushtrime</li> <li>Puna grupore në raste studimi dhe detyra</li> <li>Pjesëmarrja në diskutime lidhur me rastet e studimit</li> </ul>		
<b>Ngarkesa e studentit për lëndën</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/Javë</b>	<b>Gjithsej</b>
Ligjërata	<b>2</b>	<b>15</b>	<b>30</b>
Ushtrime, pune praktike	<b>2</b>	<b>15</b>	<b>30</b>
Kontakte me mësimdhënësit/konsultimet	<b>1</b>	<b>15</b>	<b>15</b>
Kolokviume, seminare	<b>1</b>	<b>15</b>	<b>15</b>
Detyra të shtëpisë	<b>1</b>	<b>15</b>	<b>15</b>
Koha e studimit vetanak	<b>1</b>	<b>15</b>	<b>15</b>
Përgatitja përfundimtare për provim	<b>1</b>	<b>20</b>	<b>20</b>
Projektet, prezantimet, etj.	<b>1</b>	<b>10</b>	<b>10</b>
<b>Vërejtje:</b> 1 ECTS kredi = 25 orë angazhim,p.sh nëse lënda i ka 6 ECTS kredi student duhet të ketë angazhim gjatë semestrit 150 orë.		<b>Gjithsej ngarkesa:</b>	<b>150</b>

<b>Java</b>	<b>Ligjërata</b>	<b>Orë</b>	<b>Ushtrime</b>	<b>Orë</b>
	<b>Tema</b>		<b>Tema</b>	
1	<p><b>1. Kontabiliteti i menaxhmentit dhe mjedisi i biznesit.</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Llojet e kontabilitetit dhe nocioni i kontabilitetit të menaxhmentit,</li> <li>Dallimet në mes të kontabilitetit të menaxhmentit dhe atij financiar,</li> <li>Objektivat e kontabilitetit të menaxhmentit,</li> <li>Vendosja kontabilitetit të menaxhmentit në lloje të ndryshme të ndërmarrjeve,</li> <li>Rëndësia e etikës profesionale në kontabilitetin e menaxhmentit.</li> </ul>	2	Shqyrtime të rasteve konkrete	2

2	<p><b>2. Sistemet e menaxhimit të kostos.</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Nocioni dhe natyra e kostove,</li> <li>- Struktura dhe klasifikimi i kostove,</li> <li>- Kostot e drejtëpërdrejta dhe të tërthorta,</li> <li>- Kostot e produktit dhe kostot e periudhës,</li> <li>- Kostot margjinale dhe kostot mesatare,</li> <li>- Faktorët që ndikojnë në lartësinë e kostove,</li> <li>- Kostot fikse, variable dhe të përziera,</li> <li>- Analiza e kostove të tërësishme,</li> <li>- Metodatat e përcaktimit të kostove.</li> </ul>	2	Shqyrtime të rasteve konkrete	2
3	<p><b>3. Përlllogaritja e kostos së procesit të prodhimit</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Rrjedha e kostos në procesin e prodhimit,</li> <li>- Regjistrimet kontabël.</li> </ul>	2	Shqyrtime të rasteve konkrete	2
4-5	<p><b>4. Analiza e pragut të rrezikut ose analiza Kosto-Vellim-Profiti (C-V-P)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Presupozimet dhe terminologjia e analizës së C-V-P</li> <li>- Marzha e kontributit,</li> <li>- Qasja matematikore e analizës C-V-P,</li> <li>- Qasja grafike e analizës C-V-P,</li> <li>- Raportet e C-V-P dhe pasqyrës së të ardhurave,</li> <li>- Struktura e kostove dhe leverazhi operativ,</li> <li>- Pragu i rrezikut dhe fitimi i synuar,</li> <li>- Pragu i rrezikut për produktet mikes dhe niveli i aktivitetit të nevojshëm për të përmbushur një fitim të synuar,</li> <li>- Aplikimi i analizës së C-V-P</li> </ul>	2	Shqyrtime të rasteve konkrete	2
6-7	<p><b>5. Përlllogaritja absorbuese dhe variable e kostove</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Koncepte të përgjithëshme mbi përlllogaritjen e kostove,</li> <li>- Përlllogaritja absorbuese e kostos,</li> <li>- Paqyra e të ardhurave sipas përlllogaritjes absorbuese,</li> <li>- Përlllogaritja variable e kostos,</li> <li>- Pasqyra e të ardhurave sipas përlllogaritjes variable,</li> <li>- Dallimet dhe ngjashmeritë në mes të përlllogaritjes absorbuese dhe variable të kostove.</li> </ul> <p><b>6. Pregaditja për kollokvium</b></p>	2	Shqyrtime të rasteve konkrete dhe pregaditja për kollokvium	2
8	<p><b>7. Kollokvium</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kollokviumi, zgjatë një orë mësimi apo 45 minuta dhe do të organizohet në disa grupe.</li> </ul>	2	Kollokvium	2

9	<b>8. Përrlogaritja standarde e kostove dhe analiza e shmangieve</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përcaktimi dhe vendosja e standardeve,</li> <li>- Analiza e shmangieve sipas përrlogaritjes standarde te kostove,</li> <li>- Rregjistrimi, kontabilizimi dhe shlyerja e shmangieve,</li> <li>- Rendesia e shmangieve të kostove.</li> </ul>	2	Shqyrtime të rasteve konkrete	2
10	<b>9. Analiza e kostos dhe çmimvënja</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Metoda kosto plus</li> <li>- Metoda sipas çmimeve transfere,</li> <li>- Transferi i bazuar në kosto variabile.</li> </ul>	2	Shqyrtime të rasteve konkrete	2
11	<b>10. Analiza diferenciale dhe marrja e vendimeve në afat të shkurtër.</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kostot relevante për marrjen e vendimeve,</li> <li>- Parimet në të cilat duhet bazuar marrja e vendimeve afariste,</li> <li>- Zgjedhja e teknikës në marrjen e vendimeve,</li> <li>- Marrja e vendimeve në afat të shkurtër.</li> </ul>	2	Shqyrtime të rasteve konkrete	2
12	<b>11. Buxhetimi dhe kontabiliteti i përgjegjësishë</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Buxheti i përgjithshëm,</li> <li>- Buxheti i shpenzimeve të përgjithshme,</li> <li>- Kontabiliteti i përgjegjësishë.</li> </ul>	2	Shqyrtime të rasteve konkrete	2
13	<b>12. Analiza e pasqyrave financiare</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Analiza horizontale e bilancit dhe pasqyrës së të ardhurave,</li> <li>- Analiza dhe interpretimi i bilancit krahasues dhe pasqyrën e të ardhurave,</li> <li>- Llogaritja dhe interpretimi i raciove themelore të pasqyrave financiare.</li> </ul>	2	Shqyrtime të rasteve konkrete	2
14	<b>13. Punimet seminarike</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Shqyrtimi dhe prezantimi i shkurtër i punimeve seminarike,</li> <li>- Hapja e debatit reth punimeve seminarike</li> <li>- Interpretimi interaktiv i seminareve.</li> <li>- Vlerësimi.</li> </ul>	2	Punimet seminarike	2
15	<b>14. Përmbledhje e leksioneve të mbajtura dhe pregaditja për provim.</b>	2	Përmbledhje e leksioneve të mbajtura dhe pregaditja për provim.	2

## LITERATURA:

### Literatura bazë:

1. Dr.sc. Skënder Ahmeti, “Kontabiliteti i menaxhmentit” Prishtinë 2008
2. Prof. Dr. Flutra Kalemi, “Kontabiliteti i drejtimit”, Tiranë 2008.
3. Literatura Dispenca, “Kontabiliteti i Menaxhimit”, 2012 Prof, Ass.Dr. Adem Zogjani
4. Dr. Lindita Lati & Dr. Manjola Naço, “Kontabiliteti i Drejtimit”, Tiranë 2003
5. “Cost Accounting and menagerial”– Homgren T.Charles, George Fostes, Srikant M. Datar.

### Literatura shitesë:

Dr. Lindita Lati & Dr. Manjola Naço, “Kontabiliteti i Drejtimit”, Tiranë 2003  
Prof. Dr. Isak Mustafa, libri “Biznesi dhe punësimi – Punime të zgjedhura nga tetë konferencat  
ndërkombëtare Biznesi dhe Punësimi”, Prishtinë  
“Cost Accounting and menagerial”– Homgren T.Charles, George Fostes, Srikant M. Datar

## VËREJTJE:

- Për çdo temë mësimore, studentët do të pajisen me materiale të nevojshme në gjuhën shqipe,
- Në fund të çdo ore mësimore, grupet e caktuara të studentëve do të angazhohen me detyrë apo rast studimi lidhur me temën e ligjësuar. Rezultatet e arritura nga ajo detyrë, grupet e studentëve duhet ti prezantojnë dhe t'i diskutojnë ato në orën e ushtrimeve.

## Vërejtje për studentin:

- Para së gjithash, studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe rregullat shkollore,
- Duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm në orën mësimore,
- Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e indeksit në teste dhe provim,
- Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet ti përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit.